




UNIVERSITETI "UKSHIN HOTI" PRIZREN
UNIVERSITY "UKSHIN HOTI" PRIZREN



REKTORATI

Rruga e Shkronjave Nr. 1, 20000 Prizren -Kosovë; Tel:+381 (0) 29- 232 140; Homepage: www.uni-prizren.com

Nr. ref. _____

Datë ____ . ____ . ____

Senati i Universitetit "Ukshin Hoti" në Prizren, në mbledhjen e mbajtur më 5.9.2025 mori vendim që të shpallë:

KONKURS

**PËR PRANIMIN E STUDENTËVE NË VITIN E PARË TË STUDIMEVE MASTER, PËR VITIN
AKADEMIK 2025/2026**

Senati i Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren, në bazë të kompetencave të përcaktuara sipas dispozitave të Statutit "Ukshin Hoti" Prizren, në mbledhjen e mbajtur më 23.6.2025 ka miratuar propozimet e njësisë akademike për numrin e studentëve që do të pranohen në vitin akademik 2025/26, dhe ka miratuar kushtet dhe kriteret për regjistrim në studimet themelore – master. Propozimet e numrit të studentëve pas miratimit nga Senati, gjithashtu janë aprovuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI).

I. KUSHTET E PËRGJITHSHME

1. Universiteti "Ukshin Hoti" në Prizren, në studimet postdiplomike - master për vitin akademik 2025/26 do të regjistrojë 250 studentë.
2. Nga numri i përgjithshëm i përmendur më lart, duke u bazuar në UA nr. 09/2016 të MASHTI-it, Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren (UUHP) do të regjistrojë deri në 12% përkatësisht deri 29 studentë të rregullt nga komunitetet jo-shumicë. Kuota prej 12% të vendeve të rezervuara për regjistrim të studentëve nga komuniteti jo-shumicë do të shpërndahet në mënyrë proporcionale sipas përqindjes së numrit të përgjithshëm të studentëve për secilin program të fakulteteve veç e veç.
3. Në studimet postdiplomike-master në Universitetin "Ukshin Hoti" në Prizren, mund të konkurrojnë kandidatët të cilët kanë përfunduar studimet Bachelori apo studimet themelore para hyrjes në fuqi të Deklaratës së Bolonjës në të gjitha Institucionet e akredituara të Arsimit të Lartë në Kosovë. Në kushte të barabarta, përparësi pranimi do të kenë kandidatët të cilët i kanë mbaruar studimet themelore-Bachelor në Universitetin "Ukshin Hoti" në Prizren.
4. Të drejtë konkurrimi kanë gjithashtu edhe kandidatët të cilët studimet themelore i kanë përfunduar jashtë Kosovës. Në raste të tilla kandidati duhet të sjellë vendimin mbi nostrifikimin e diplomës (vendimi për njohje/nostrifikim të diplomave lëshohet nga MASHTI).
5. Kandidatët të cilët kanë përfunduar studimet paraprake në një program studimi, mund të konkurrojnë për regjistrim në studimet master në një program tjetër. Në rast pranimi, Komisioni i Studimeve të njësisë akademike mund të caktojë provime diferenciale të cilave duhet t'iu nënshtrohen paraprakisht kandidatët. Komisioni i Studimeve cakton numrin e provimeve varësisht nga shkalla e krahasueshmërisë /ngjashmërisë së programit me studimet themelore të kandidatit. Kandidatët do të kenë më së shumti deri në pesë provime diferenciale të cilave do t'iu nënshtrohen para komisionit prej tre anëtarësh ndërsa procesverbalet e provimeve të tilla ratifikohen nga këshilli i njësisë akademike përkatëse.
6. Kandidatët të cilët kanë të regjistruar një program studimi në cilindo nivel të studimit në kuadër të Universitetit, nuk kanë të drejtë konkurrimi në një program tjetër studimi në Universitetin "Ukshin Hoti" Prizren, pa i përfunduar studimet në programin ku janë duke vijuar studimet ose pa u reregjistruar nga programi aktual i studimeve. Kandidatët për pranim si studentë të UUHP-së në vitin akademik 2025/26 nuk mund të konkurrojnë më shumë se në një fakultet, drejtim apo program.
7. Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren, mbi bazën e konsideratave humane, kandidatëve me nevoja të veçanta, me rastin e provimit pranues do t'ua shtojë nga 5 pikë bonus. Statusi i kandidatëve me nevoja të veçanta duhet të dëshmohet me certifikata përkatëse, të lëshuar nga institucionet gjegjëse.

II. MËNYRA E PËRZGJEDHJES SË KANDIDATËVE

1. Përzgjedhja e kandidatëve për të gjitha fakultetet do të bëhet sipas kritereve në vijim:
Numri maksimal i pikëve sipas kritereve vijuese është 100 pikë, dhe atë:
-Suksesi në studimet themelore deri në 30 % të pikëve;
-Suksesi në provim pranues deri në 70 % të pikëve;
2. Të drejtë radhitjeje, përkatësisht pranimi kanë vetëm kandidatët që arrijnë 40% nga numri i pikëve të parapara për provim pranues.
3. Kandidatët të cilët nuk arrijnë 40% nga numri i pikëve të parapara për provim pranues nuk mund të pranohen edhe nëse mbeten vende të paplotësuar sipas konkursit.
4. Nëse numri i pikëve të disa kandidatë të ranguar si të fundit në listën e të pranuarve është i barabartë me kandidatë tjerë jashtë numrit të planifikuar për pranim, përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të suksesit të provimit pranues, e nëse edhe pikët e provimit pranues janë të njëjta atëherë do të merret parasysh suksesi i studimeve themelore. Në qoftë se edhe suksesi është i njëjtë atëherë përparësi do të kenë kandidatët e gjinisë femërore. Fakultetet janë të obliguara që listën e kandidatëve, të cilët kanë konkurruar, t'ia dërgojnë Rektoratit të Universitetit dhe ta publikojnë në ueb-faqen zyrtare.
5. Njësitë akademike fillimisht shpallin rezultatet preliminare, në bazë të cilave rezultatet e kandidatëve që nuk janë pranuar fitojnë të drejtën e ankesës dhe vetëm pas shqyrtimit të ankesave dalin listat përfundimtare të cilat në asnjë rast nuk duhet të tejkalojnë numrin total të vendeve të shpallura në konkurs. Kandidatët që gjenden në fund të listës së të pranuarve sipas rezultateve preliminare nuk e kanë të garantuar vendin deri në përfundim të afatit të ankesave.

III. AFATET E KONKURSIT

1. Aplikimi dhe paraqitja e dokumenteve bëhet prej datës 8.9.2025 deri më datë 19.9.2025 nga ora 09:00 deri 16:00 (çdo ditë përjashtuar të dielën) ditën e fundit aplikacionet pranohen deri në ora 16:00.
2. Për aplikim kandidatët duhet t'i sjellin këto dokumente:

-Fletëaplikacioni i plotësuar i cili shkarkohet gjatë aplikimit online nga interneti; linku për aplikim: smu.uni-prizren.com
-Ekstraktin e lindjes (origjinale).
-Diplomën origjinale, kopje të notirezuar, përkatësisht certifikatën e diplomimit origjinale ose të noterizuar.
-Pasqyrën e notave në studimet themelore, (përjashtuar kandidatët që studimet baçelor i kanë kryer në UUHP).
-Për kandidatët të cilët studimet themelore i kanë përfunduar jashtë Kosovës duhet të kenë edhe vendimin për njohjen e diplomës nga MASHTI.
-Dëshmia e akreditimit të Institucionit të Arsimit të Lartë për kandidatët që kanë mbaruar studimet jashtë vendit dhe në kolegjet private në Republikën e Kosovës.
-Kandidatët me rastin e aplikimit, bazuar në UA 09/2021 lirohen nga pagesa e provimit pranues.
-(Ju lutemi që gjatë aplikimit plotësoni saktësisht të dhënat personale dhe informatat tjera sepse me këto informata do të kontaktojë Universiteti me studentët sidomos me email-adresa ku ju do të njoftoheni për çdo aktivitet të Universitetit në relacionin Aplikues-Student-Universitet)

8. Provimi pranues do të mbahet më datë 22.9.2025

-Fakulteti Ekonomik- Administrim Biznesi më datë 22.9.2025 ora 16:00
-Fakulteti i Shkencave Kompjuterike- Shkenca Kompjuterike dhe Teknologji Komunikimi më datë 22.9.2025 ora 16:00
-Fakulteti i Shkencave të Jetës dhe Mjedisit- Menaxhimi në Agrobiznes më datë 22.9.2025 ora 16:00
-Fakulteti Juridik-Qeverisje Demokratike dhe Sundimi i Ligjit më datë 22.9.2025 ora 16:00
-Fakulteti i Edukimit- Shkencat e Edukimit, specializimi Mësimdhënie-Programi-gjuhë shqipe më datë 22.9.2025 ora 16:00
-Fakulteti i Edukimit- Shkencat e Edukimit, specializimi Mësimdhënie-Programi-gjuhë turke më datë 22.9.2025 ora 16:00
-Fakulteti i Edukimit- Shkencat e Edukimit, specializimi Mësimdhënie-Programi-gjuhë boshnjake më datë 22.9.2025 ora 16:00

Të gjithë kandidatët në provim pranues duhet ta posedojnë njërin nga dokumente identifikuese: letërnjoftim, pasaportë apo patentë shoferin, pa njërin nga të cilën nuk mund t'i nënshtrohen provimit pranues.

Në kohën e mbajtjes së provimit pranues ndalohet përdorimi i telefonave celularë!

9. Shpallja e rezultateve preliminare do të bëhet më datë 23.9.2025 ora 10:00 në faqen zyrtare të Universitetit.

10. Afati për ankesa është deri më datë 24.9.2025 ora 23:59 ndërsa ankesa parashtrohet online smu.uni-prizren.com, dhe shqyrtimi i tyre do të bëhet më datë 25.9.2025 ora 09:00 kandidatët duhet të jenë të pranishëm në shqyrtimin e ankesës.
11. Ndërsa shpallja e rezultateve përfundimtare do të bëhet më së largu më datë 25.9.2025 ora 14:00.

IV. REGJISTRIMI I KANDIDATËVE TË PRANUAR PAS SHPALLES SË REZULTATEVE

Fotografimi dhe regjistrimi i studentëve të pranuar:

- Fakulteti Ekonomik-Administrim Biznesi: 26.9.2025 deri më 30.9.2025 prej orës 09:00-15:00
- FSHK-Shkenca Kompjuterike dhe Teknologji Komunikimi: 26.9.2025 deri më 30.9.2025 prej orës 09:00-15:00
- FSHJM-Fakulteti i Shkencave të Jetës dhe Mjedisit–Menaxhim në Agrobiznes: 26.9.2025 deri më 30.9.2025 prej orës 09:00-15:00
- Fakulteti Juridik- Qeverisje Demokratike dhe Sundim i Ligjit: 26.9.2025 deri më 30.9.2025 prej orës 09:00-15:00
- Fakulteti i Edukimit- Shkencat e Edukimit, specializimi Mësimdhënie-Programi-gjuhë shqipe: 26.9.2025 deri më 30.9.2025 prej orës 09:00-15:00
- Fakulteti i Edukimit- Shkencat e Edukimit, specializimi Mësimdhënie-Programi-gjuhë turke: 26.9.2025 deri më 30.9.2025 prej orës 09:00-15:00
- Fakulteti i Edukimit- Shkencat e Edukimit, specializimi Mësimdhënie-Programi-gjuhë boshnjake: 26.9.2025 deri më 30.9.2025 prej orës 09:00-15:00

Kandidatët e pranuar për regjistrim duhet të paraqesin:

-Fletëregjistrimi i plotësuar e cila merret me rastin e fotografimit.

-Një fotografi formati 6x4.

Bazuar në UA 09/2021, kandidatët e pranuar lirohen nga pagesa për regjistrim të semestrave për herën e parë.

Lutemi që t'i përbaheni afatit të lartshënuar, në rast të lëshimit të këtyre afateve përgjegjësia bie mbi kandidatin për mosrespektim të tij. Kandidatët të cilët nuk arrijnë të regjistrohen (fotografohen) sipas datave të shënuara do ta humbin mundësinë e regjistrimit, andaj ju lutemi që t'i përbaheni afateve të caktuara.

I. Numri i studentëve për nivelin Master të cilët do të pranohen në Universitetin “Ukshin Hoti” në Prizren - sipas programeve është si në tabelën:

Njësia Akadematike	Programi	Kodi	Për studime të rregullta	Kandidatë nga komunitetet jo shumicë UA 09/2016 12%	Gjithsej
FAKULTETI I EKONOMISË	Administrim Biznesi	01	70	10	80
FAKULTETI I SHKENCAVE TË JETËS DHE MJEDISIT	Menaxhimi në Agrobiznes	32	13	2	15
FAKULTETI I SHKENCAVE KOMPJUTERIKE	Shkencat Kompjuterike dhe Teknologji Komunikimi	27	40	5	45
FAKULTETI JURIDIK	Qeverisje Demokratike dhe Sundimi i Ligjit	33	35	5	40
	Shkencat e Edukimit, specializimi Mësimdhënie dhe Kurrikulë-Programi- Gj. Shqipe	16	27	3	30

FAKULTETI I EDUKIMIT	Shkencat e Edukimit, specializimi Mësimdhënie dhe Kurrikulë- Programi- Gj. Turke	17	18	2	20
	Shkencat e Edukimit, specializimi Mësimdhënie dhe Kurrikulë- Programi- Gj. Boshnjake	18	18	2	20

V. KUSHTET E VEÇANTA PËR APLIKIM SIPAS FAKULTETEVE

1. Administrim Biznesi :

Kandidatët të cilët dëshirojnë të aplikojnë në këtë program studimi, duhet të kenë të përfunduar studimet e nivelit themelor në njërin nga këto fakultete-programe:

- Fakultetin e Ekonomisë,
- Fakultetin e Juridikut,
- Fakultetin e Shkencave Politike,
- Fakultetin e Agrobiznesit.

2. Shkenca Kompjuterike dhe Teknologji Komunikimi:

Kandidatët të cilët dëshirojnë të aplikojnë në këtë program studimi, duhet të kenë të përfunduar studimet e nivelit themelor në njërin nga këto drejtime:

- Shkenca Kompjuterike,
- Telekomunikacion,
- Mekatronikë,
- Elektronikë,
- Informatikë Ekonomike,
- Matematikë Kompjuterike
- Matematikë- Informatikë, Teknologji-Informatikë.

3. Menaxhimi në Agrobiznes:

Kandidatët të cilët dëshirojnë të aplikojnë në këtë program studimi, duhet të kenë të përfunduar studimet e nivelit themelor në njërin nga këto fakultete-programe:

- Agrobiznes,
- Ekonomiksi,
- Zhvillim Rural,
- Agronomi
- Juridik (E Drejta Biznesore dhe e Drejta Financiare)

3. Qeverisje Demokratike dhe Sundimi i Ligjit:

Të drejtë aplikimi në programin master kanë kandidatët që kanë përfunduar studimet në nivelin baçelor (BA) me së paku 240ECTS, fushat të cilat kanë të drejtë të aplikojnë për regjistrimin në programin Master "Qeverisje Demokratike dhe Sundimi i Ligjit", janë:

- Të diplomuarit në fushën e Drejtësisë,
- Shkencat politike,
- Administrat publike dhe
- Shkencat sociale

5. Shkencat e Edukimit, specializimi Mësimdhënie dhe Kurrikulë – programi në gjuhë shqipe:

Fushat e të drejtës së aplikimit kanë kandidatët që:

Kanë përfunduar studimet në nivelin Baçelor (BA) me së paku 180 ECTS, në Fakultetet e Edukimit të universiteteve publike në Republikën e Kosovës.

6. Shkencat e Edukimit, specializimi Mësimdhënie dhe Kurrikulë – programi në gjuhë turke:

Fushat e të drejtës së aplikimit kanë kandidatët që:

Kanë përfunduar studimet në nivelin Baçelor (BA) me së paku 180 ECTS, në Fakultetet e Edukimit të universiteteve publike në Republikën e Kosovës.

7. Shkencat e Edukimit, specializimi Mësimdhënie dhe Kurrikulë – programi në gjuhë boshnjake:

Fushat e të drejtës së aplikimit kanë kandidatët që:

Kanë përfunduar studimet në nivelin Baçelor (BA) me së paku 180 ECTS, në Fakultetet e Edukimit të universiteteve publike në Republikën e Kosovës.

PROVIMI PRANUES DO TË MBAHET NGA LËNDËT SI NË VIJIM:

FAKULTETI I EKONOMISË- Administrim Biznesi

- Makroekonomi;
- Mikroekonomi;
- Bazat e Menaxhimit;
- Financat e Korporatave;
- Marketing;
- Menaxhimi i Burimeve Njerëzore;
- Biznesi Ndërkombëtar;
- Kontabilitet.

FAKULTETI I SHKENCAVE KOMPJUTERIKE- Shkencat Kompjuterike dhe Teknologji Komunikimi

- Arkitektura Kompjuterike dhe Sistemi Operativ
- Rrjetat Kompjuterike
- Bazat e të Dhënave
- Logjika dhe Matematika
- Algoritmet dhe Programimi

FAKULTETI I SHKENCAVE TË JETËS DHE MJEDISIT- Menaxhimi në Agrobiznes

- Ekonomik
- Menaxhimi i Fermave
- Marketing Agroushqimor
- Biznes Ndërkombëtar
- Politikat Bujqësore

FAKULETI JURIDIK- Qeverisje Demokratike dhe Sundimi i Ligjit

- Fusha Penale
- Administrata Publike
- Sundimi i Ligjit

FAKULTETI I EDUKIMIT- Shkencat e Edukimit, specializimi Mësimdhënie dhe Kurrikulë- programi në gjuhë shqipe

- Fusha e mësimdhënies/kurrikulës
- Fusha e pedagogjisë
- Gjuhë Angleze

FAKULTETI I EDUKIMIT- Shkencat e Edukimit, specializimi Mësimdhënie dhe Kurrikulë- programi në gjuhë turke

- Fusha e mësimdhënies/kurrikulës
- Fusha e pedagogjisë
- Gjuhë Angleze

FAKULTETI I EDUKIMIT- Shkencat e Edukimit, specializimi Mësimdhënie dhe Kurrikulë- programi në gjuhë boshnjake

- Fusha e mësimdhënies/kurrikulës
- Fusha e pedagogjisë
- Gjuhë Angleze

Prof. Asoc. Dr. Mentor Alishani

Kryesues i Senatit